



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME, KORÇË

Nr 64 prot

Korçë më 02.11.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar : Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

Mësimdhënës me kohë të pjesëshme, me ngarkesë mësimore 150 ore/vjetore për modulin mësimor me kod; M-10-1070-14.

Mësues i kulturës profesionale lëndët teorike profili mësimor Dizënjim Mode (pas të mesëm).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- m) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- n) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- o) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- p) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- q) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- r) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet te plotesoje Kriteria të posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose te barazvlefshem me te ne të njëjtën fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit te AFP-së.
- b) Të ketë të paktën 1 (nje) vit eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

- 2) Dosja e aplikimit , e cila permban dokumentacionin e kerkuar , sipas njoftimit te vendit te lire, duhet te perfshije :
 - a) letër motivimi për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 te ketij udhezimi
 - b) kartën e identitetit,
 - c) diplomën
 - d) librezën e punës;
 - c) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
 - d) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - e) vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
 - f) vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
 - g) vërtetim nga punëdhënësi I fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
 - h) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të tyre të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorezohen ne protokollin e ofruesit te AFP-se brenda dates.....14.11.2023.....

TATIANA MERO
DREJTORI SHKOLËS

